



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 15.04.2025

NR.09/ 2575 /2025

KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës ¹: 659-25-2255-1-3-6/C622 & KKHE-25-012-1-3-6

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

N.T. "BITI-COM", (Berat Kaciu B.I.) LUPÇ I POSHTËM P.N., PODUJEVË, me NUI 810779366 (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me fidane te pemëve per fermerë (arre, molle, kumbull) me numër identifikues: 659-25-2255-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	
1	Furnizim me fidane te pemëve per fermerë (arre, molle, kumbull)

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues. [Kohëzgjatja e kontratës është me afat prej një (1) muaj nga koha e nënshkrimit të kësaj palë]

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë Komuna Hani i Elezit .

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 3,492.30 €; [Tremijë e katërqind e nëntdhjetë e dy Euro /30 cent]

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Çmimi duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	<i>pe</i> Xhevdet Bushi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	15.04.2025
Vula:	

Për Furnizuesin N.T. "BITI-COM"

Emri:	Berat Kaçi
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	15.04.2025
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri I kontratës: 659-25-2255-1-3-6/C622

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	9.1	<u>[Sigurimi i ekzekutimit të kontratës në 10% e vlerës së kontratës me afat prej 2 muajve apo 60 diteve]</u>
Sigurimi	10.1	<u>[Sigurimi i ekzekutimit të kontratës në 10% e vlerës së kontratës me afat prej 2 muajve apo 60 diteve]</u>
Programi i ekzekutimit	11	<u>[Kohëzgjatja e kontratës është me afat prej një (1) muaj nga koha e nënshkrimit të sa mes palëve]</u>
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	<u>[shëno kushtet e dorëzimit]</u>
Patentat dhe licencat	13.1	<u>[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]</u>
Vonesat në ekzekutim	16.1	Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
Menaxheri i kontratës	17	Menaxheri i kontratës do të caktohet me vendim të veçant të ZKA-se
Cilësia e furnizimeve	18.2	<u>[Furnizimet duhet të jenë konform specifikimeve të kërkuara dhe të jenë kualitative]</u>
Inspektimi dhe testimi	19.2	<u>[Artikujt do të shiqohen, kontrollohen për cilësi dhe sasi dhe me pas të pranohen nga AK]</u>
Pagesa	20.1	<u>[Pagesa do të bëhet pas pranimit të furnizimit të pranuar nga AK- dhe pas pranimit të fatures]</u> <u>Pagesa do të bëhet brenda afatit ligjor]</u>
Dorëzimi	21.3	<u>[Furnizimet duhet të dorëzohen brenda afatit kohor dhe pa defekte sipas kërkesës së AK-se]</u>
Obligimet e garancionit	24.1	<u>[shëno periudhën e garancionit]</u>
	24.5	<u>[Specifikoni ndonjë obligim shtesë sipas garancisë]</u>
Shërbimet pas shitjes	25.1	<u>[Jepni detajet e shërbimit pas shitjes që Furnizuesi duhet të sigurojë dhe përcaktoj raportin e sigurisë së ekzekutimit të caktuar për këtë aktivitet]</u>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<u>[Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit të Elezit ose përmes procedurave alternative të zgjidhjeve se mosmarrëveshjeve-procedurat e ndërmjetësimit me pajtimin e të dy palëve]</u>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <u>[Gjykata Komerciale Në Prishtinë]</u> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <u>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</u> në pajtim me <u>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</u> .